

UDHËZIM
Nr.7, datë 23.4.2005

**PËR PROCEDURAT DHE AFATIN E HEQJES SË ZGJEDHËSVE, QË SHËRBEJNË NË
FORCAT E ARMATOSURA E NË FORCAT E RENDIT DHE TË STUDENTËVE, NGA
LISTAT E ZGJEDHËSVE TË VENDBANIMIT TË TYRE**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e tij të datës 23.4.2005, me pjesëmarrjen e:

Ilirjan Celibashi	Kryetar
Çlirim Gjata	Anëtar
Dëshira Subashi	Anëtar
Dodë Prenga	Anëtar
Klement Zguri	Anëtar
Pandeli Varfi	Anëtar

Në mbështetje të nenit 29 pika 1, nenit 64 pika 3 dhe nenit 64/1 pika 6 të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

UDHËZON:

Neni 1

Qëllimi

Ky udhëzim ka për qëllim të përcaktojë procedurat dhe afatin që do të zbatojnë kryetarët e njësive të qeverisjes vendore për heqjen nga lista e zgjedhësve të vendbanimit të tyre, të zgjedhësve që shërbejnë në Forcat e Armatosura e në Forcat e Rendit dhe të studentëve, të cilët do të ndodhen në vendqëndrimet e tyre, në periudhën 60 deri në 30 ditë nga data e përfundimit të mandatit të Kuvendit.

Neni 2

Kryetarët e njësive përkatëse të qeverisjes vendore, brenda 5 ditëve nga marrja e kërkesës nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, pasi verifikojnë nëse zgjedhësit e kërkuar janë në listën e zgjedhësve të asaj njësie, marrin vendim për heqjen e këtyre zgjedhësve nga lista e zgjedhësve të vendbanimit të tyre.

Neni 3

Vendimi hartohet në tri kopje, nga të cilat njëra afishohet së bashku me listën përfundimtare të zgjedhësve, njëra ruhet pranë organit vendimmarrës, së bashku me kërkesën e dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe kopja e tretë, brenda 2 ditëve nga marrja e vendimit, i dërgohet kësaj të fundit. Njësia e qeverisjes vendore i dërgon Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, krahas vendimit, edhe listën e zgjedhësve (nëse ka), të shënuar në kërkesën e ardhur prej saj, por që nuk ndodheshin në listën e zgjedhësve të njësisë përkatëse.

Neni 4

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.